

Dialogu dhe Normalizimi: Vështrim nga Vendngjarja

Diskutim mes analistëve të Kosovës dhe të Serbisë dhe përfaqësuesve të shteteve të QUINT-it

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG) organizoi dy diskutime, më 14 dhe 17 Dhjetor 2020 për një grup analistësh nga Kosova dhe Serbia dhe për diplomatë përgjegjës për Ballkanin Perëndimor nga shtetet e Quint-it (Franca, Gjermania, Italia, Britania e Madhe dhe SHBA-të), si dhe nga Zvicra dhe EEAS (Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm). Takimi i parë shërbeu si mundësi për shkëmbimin e mendimeve dhe rafinimin e mesazheve që analistët synuan t'u përcjellin përfaqësuesve të Quint-it. Pas takimit të parë, CIG përgatiti një draft të konkluzioneve dhe rekomandimeve për të shërbyer si bazë për diskutimin e dytë me zyrtarët e Quint-it. Pas takimit të dytë me përfaqësuesit e Quint-it, CIG hartoi këtë raport të shkurtër. Jemi përpjekur të jemi të saktë dhe të ekuilibruar në përmbledhjen e pikave të diskutimit dhe kërkojmë mirëkuptim nga pjesëmarrësit, vërejtjet e të cilëve mund të mos jenë përfshirë plotësisht në këtë raport.

Më poshtë janë një seri përfundimesh dhe rekomandimesh që dolën nga dy diskutimet. Këto përfundime nuk bazohen në konsensus, por në marrëveshje të gjerë dhe disa prej tyre në mendime të pjesëmarrësve individualë. Ato nuk përfaqësojnë pikëpamjet e CIG-së ose Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës (FDFA) i cili mbështet projektin. Diskutimi bazohet në rregullen e mos-atribuimit të Chatham House.

Përfundimet dhe rekomandimet e analistëve

- Administrata e re e SHBA mund të sjellë një ndryshim të rëndësishëm. Rivendosja dhe zhvillimi i bashkëpunimit dhe partneritetit të mëtejshëm SHBA-BE, përfshirë çështjen e mosmarrëveshjes Kosovë-Serbi, duhet të jetë një përparësi e përbashkët mes SHBA dhe BE.
- Dialogu i mëparshëm i udhëhequr nga BE dhe ai aktual tregojnë se arritja e një marrëveshjeje mes Serbisë dhe Kosovës është e komplikuar, dhe një normalizim i shpejtë nuk duket i shpejtë. Palët duhet të përgatiten për një proces të gjatë dhe të lodhshëm. Dialogu i lehtësuar nga BE-ja duhet të formulohet rreth katër pyetjeve: Çfarë kuptojmë konkretisht me normalizimin e marrëdhënieve? Çfarë i duhet Kosovës dhe Serbisë nga BE? Çfarë ka synuar deri më tani dialogu i mëparshëm dhe cilat janë rezultatet e zbatuara të tij? Cili është dallimi mes marrëveshjeve teknike dhe atyre politike?
- BE duhet të veprojë më shumë si aktor me rol kyç sesa me rol lehtësues. Vendosja e qëllimeve të reja ndërmjetësuese është një mënyrë për të zhblokuar ngërçin aktual dhe për të siguruar një lëvizje të rëndësishme përpara. Perspektiva ndërkombëtare e Kosovës, dhe ç'është më e rëndësishmja, perspektiva e saj më konkrete euro-atlantike duhet të zhblokohet gjatë procesit të dialogut, dhe BE duhet ta shohë këtë si një synim kryesor të ndërmjetëm, pavarësisht se

është një detyrë sfiduese. Një synim i ndërmjetëm për Serbinë mund të jetë krijimi i tregut rajonal.

- Një zgjidhje Serbi-Kosovë duhet të jetë pjesë e një vizioni të ri gjithëpërfshirës të BE-së për rajonin. Kjo është thelbësore për të siguruar qëndrueshmëri të rezultateve të dialogut. Anasjelltas, Serbia dhe Kosova nuk duhet të përdorin dialogun si një justifikim për të lënë pas dore reformat e brendshme, veçanërisht sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe lirinë e medias, pasi këto janë çështjet kryesore për anëtarësimin në BE.
- BE-ja duhet të rregullojë zbatimin e 'shkopinjve dhe karrotave' për t'i bërë gjërat të bëhen në mënyrë më efektive. BE-ja nuk duhet të lejojë kompromise për sundimin e ligjit, por poashtu duhet të mbajë premtimet e saj, siç është liberalizimi i vizave për Kosovën.
- 'Asgjë nuk është rënë dakord derisa gjithçka të bihet dakord' është një parim i ndërlikuar pasi mund të pengojë padashur dialogun. Për të demonstruar se dialogu po sjellë ndryshim, kur diçka e re bihet dakord, nuk duhet të pritët që menjëherë do të ketë zbatim të marrëveshjes përfundimtare.
- BE dhe procesi i dialogut do të përfitonin nëse do të kishte më shumë transparencë.
- Zëri i serbëve të Kosovës duhet të përfshihet në dialog. Deri më tani, pozita e tyre është neglizhuar, edhe pse ky komunitet ishin pika kryesore për negociim mes dy palëve.
- Shumica e marrëveshjeve të dialogut janë zbatuar në masë të madhe, disa vetëm pjesërisht, kurse vetëm Asociacioni/Komuniteti dhe kadastra kanë mbetur pa u zbatuar. BE-ja duhet të sigurojë një interpretim të veçantë në lidhje me ASM-në dhe të bindë palët ta pranojnë atë. Krijimi i ASM-së do të eliminonte një pengesë të rëndësishme për arritjen e një marrëveshjeje politike. Poashtu, zbatimi i plotë i marrëveshjeve të tjera (IBM, diploma dhe liria e lëvizjes në veçanti) do të ndihmonin në avancimin e integritit ekonomik si Zonës Ekonomike Rajonale, apo të ashtuquajturin "Mini Schengen".

Përfundimet dhe rekomandimet e analistëve dhe përfaqësuesve të Quint-it

- Arsyeja prapa Marrëveshjeve të Washingtonit është rritja e komunikimit dhe ndërtimi i besimit përmes nxitjes së bashkëpunimit praktik në terren, veçanërisht në fushën e ekonomisë, dhe duke i dhënë fund përfundimisht qasjes si *shuma zero* midis palëve. Administrata e re amerikane ka të ngjarë të mos e braktisë këtë qasje. Përpjekjet e SHBA-ve për normalizimin praktik duhet të shoqërohen nga më shumë përpjekjet e BE-së, duke synuar ta sjellin rajonin më pranë BE-së. BE-ja dhe SHBA-të duhet të vazhdojnë të bashkëpunojnë ngushtë mbi këtë çështje.
- Perspektivat e BE-së ekzistojnë si për Serbinë, ashtu edhe për Kosovën. Tani ekziston një metodologji e re dhe rajoni tashmë ka marrë më shumë mbështetje se çdo shtet tjetër në zhvillim nga BE-ja. Mirëpo, në mënyrë që palët të përparojnë më shpejt drejt anëtarësimit në BE, ato duhet të zbatojnë reformat më shpejt. Metodologjia e re mund të mos jetë e mjaftueshme. Për të nxitur procesin, BE-ja duhet të vijë me një datë për një anëtarësim potencial dhe me një listë konkrete elementesh (të paraqitura në formë të qartë për publikun e vendeve kandidatë) që duhet të zbatohen në mënyrë që anëtarësimi të ndodhë. Kandidati që përmbush këto kushte automatikisht do të bëhet anëtar i BE-së në datën e planifikuar.

- Një regjim pa viza për Kosovën është ende një temë debati, sepse disa nga vendet anëtare të BE-së kanë frikë se sundimi i ligjit në Kosovë mbetet në një gjendje të keqe, pavarësisht se janë plotësuar kushtet e vendosura nga Komisioni Evropian. Shtetet anëtare të BE-së poashtu kanë frikë nga imigrimi i paligjshëm. Procesi tani është subjekt i një dialogu midis ministrive të brendshme të Kosovës dhe disa vendeve anëtare të BE-së.
- Zbatimi i marrëveshjeve teknike ndërmjet Serbisë dhe Kosovës është një parakusht për arritjen e integritet më të madh në nivelin rajonal. Prandaj, BE-ja duhet vërë theks më të fortë në zbatimin e marrëveshjeve.
- Normalizimi gjithëpërfshirës duhet të mbetet si synimi i dialogut. Sidoqoftë, zbatimi i tij mund të ndahet në segmente të emëruara si qëllime të përkohshme.
- Është vështirë të shënohet progres për njohjen nga pesë vendet anëtare të BE-së që nuk e njohin Kosovën, pa pasur një situatë më të qartë lidhur me normalizimin gjithëpërfshirës mes Beogradit dhe Prishtinës. Të gjitha shtetet mosnjohëse kanë treguar vendosshmëri në qëndrimet e tyre.

Nuk ka asnjë alternativë ndaj dialogut Beograd-Prishtinë dhe e vetmja mundësi mbetet vazhdimi i negociatave. Të gjitha opsionet e tjera do të ishin shumë të dëmshme për të dy palët. Duhet të mirret parasysh se në planin afatgjatë, çështja e statusit nuk mund të shmanget, por dialogu mund të kalojë në faza përmes rezultateve të ndërmjetme. Duhet të mirret parasysh se nëse dështon procesi i Brukselit, nocioni i zgjidhjes së çështjes me territore- ndarja, shkëmbimi i territoreve ose ndonjë model tjetër - ka të ngjarë të rishfaqet përsëri.

SHBA-të dhe BE-ja po punojnë ngushtë në dialogun mes Serbisë dhe Kosovës, megjithë dallimet e tyre kohëve të fundit. Emërimi i të dërguarit të BE-së për dialogun është hap i mirë në drejtimin e duhur. Miroslav Lajcak ka arritur të rifillojë dialogun por po përballet me sfida të ndryshme për të bërë përparim. Me një administratë të re të SHBA-ve, dialogu mund të ketë nevojë për një rivendosje dhe një kornizë të re të bazuar në një bashkëpunim më të mirë transatlantik. Ndërmjetësit ose lehtësuesit kanë nevojë për më shumë mbështetje nga SHBA-të dhe vendet e Quint-it. Duhet pritur që mbështetja e SHBA-ve për Miroslav Lajcak dhe ekipin e tij do të vazhdojë dhe se ajo do të mbetet e fortë.

Lidhur me mësimet e nxjerra nga dialogu i mëparshëm, ka nevojë për më shumë masa për ndërtimin e besimit, transparencën e rezultateve të dialogut dhe artikulin e tyre të qartë. Atmosfera aktuale midis ekipeve negociuese duket më shumë si një konkurs që synon arritjen e sukseseve për hir të opinionëve të brendshme vendase, sesa një dialog që duhet të çojë në një kompromis të qëndrueshëm. Në këtë drejtim, paqartësia konstruktive e vlerësuar më parë nuk sjellë dobi, dhe përfaqësuesit e BE-së poashtu duhet të përmbahen nga dhënia e mesazheve të ndryshme dhe shpesh kontradiktore në Beograd, Prishtinë dhe Bruksel. Në fund, BE-ja dhe vetë procesi i dialogut do të përfitonin më shumë nëse do të kishte më shumë transparencë. Dialogu i mëparshëm ka qenë i fshehtë pa nevojë. Publiku duhet të jetë më i informuar në lidhje me marrëveshjet e arritura dhe detajet e tyre, nëse palët e përfshira në dialog duan të forcojnë mbështetjen gjatë procesit të normalizimit.

Pjesëmarrësit

Analistët dhe CIG

Nikola Burazer, Qendra për Politikë Bashkëkohore

Shpetim Gashi, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Ismet Hajdari, Analist

Ramadan Ilazi, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Jeta Krasniqi, Instituti Demokratik i Kosovës

Srecko Latal, Rrjeti Ballkanik për Raportim Hulumtues

Jeta Loshaj, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Agon Maliqi, Sbunker

Petar Miletic, Analist

Igor Novakovic, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Saso Ordanoski, Analist

Natasa Petrovic, Trusti Ballkanik për Demokraci i Fondit Gjerman Marshall

Alex Roinishvili Grigorev, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Marko Savkovic, Fondi i Beogradit për Ekselencë Politike

Stefan Surlic, Fakulteti i Shkencave Politike Beograd

Diplomatët

Thomas Bertin, Ministria e Francës për Evropë dhe Punë të Jashtme

Andrea Cascone, Ministria e Italisë për Punë të Jashtme dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Ian Cliff, Zyra e Jashtme dhe Federale e Mbretërisë së Bashkuar

Simon Geissbuehler, Departamenti Federal i Zvicrës për Punë të Jashtme

Carlo Guinipero, Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm

Christiane Hullmann, Zyra e Jashtme Federale Gjermane

Alexander Jung, Kancelaria Federale Gjermane

David Kostelancik, Departamenti i Shtetit SHBA

Susan Laffey, Zyra e Jashtme dhe Federale e Mbretërisë së Bashkuar

Matthias Luettenberg, Kancelaria Federale Gjermane

Pauline Menthonnex Gacafferri, Departamenti Federal i Zvicrës për Punë të Jashtme

Jean-Luc Oesch, Departamenti Federal i Zvicrës për Punë të Jashtme

Paul Pfeuffer, Departamenti i Shtetit SHBA

Roland Salvisberg, Departamenti Federal i Zvicrës për Punë të Jashtme

Christoph Spaeti, Departamenti Federal i Zvicrës për Punë të Jashtme